

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deputeti i Partisë Demokratike -
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919743/narkoshteti-pengon-integrimin-gjekmarkaj-shqiperia-nuk-shkon-ne-europe-me-deklarata-por-me-reforma-reale/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 14:52:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 14:34:27 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2bde857e340d6dce4b48b8269df10e7bef8ea0b0217f888b0ce71510194db12c
TEKSTI	1bbd67c542cda9a2cdb202390f5deeeff50405839f8f954d10682c3a40aeb221
PAMJA	c332c419896096b37eb1e679a4c0ec527d8b690366e697f3b5bd23d3fad2586d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	23ac0f1b46c0bb4899d42957da40c6dfa878a3d4788e4c994c7ef2a39e938e34
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/23ac0f1b46c0bb4899d42957da40c6dfa878a3d4788e4c994c7ef2a39e938e34>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEĐA

'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



'Narkoshteti' pengon integrimin', Gjekmarkaj: Shqipëria nuk shkon në Europë me deklarata, por me reforma reale

16:34, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Deputeti i Partisë Demokratike Agron Gjekmarkaj, ka hedhur akuza të forta ndaj qeverisë Rama gjatë fjalës së tij në një konferencë me përfaqësues të parlamenteve europiane, duke deklaruar se "narkoshteti" është një nga pengesat kryesore për europianizimin e Shqipërisë.

Gjekmarkaj tha se opozita e mbështet pa rezerva anëtarësimin në BE, por theksoi se Shqipëria nuk mund të shkojë drejt Europës vetëm me deklarata politike, por me reforma reale, institucione funksionale dhe standarde demokratike.

Ai kritikoi mazhorancën për mungesën e konsensusit në reformat zgjedhore e territoriale dhe akuzoi qeverinë se përdor pushtetin për të penguar drejtësinë dhe për të mbrojtur persona të përfshirë në afëra korruptive.

"Korrupsioni nuk luftohet duke mbrojtur të korruptuarit; ai luftohet duke mbrojtur ligjin", deklaroi Gjekmarkaj, duke shtuar se Shqipëria ka nevojë për zgjedhje të lira, drejtësi të besueshme, institucione të pavarura dhe respekt për qytetarin, si standarde konkrete të rrugës drejt Bashkimit Europian.

Fjala e plotë:



Të nderuar kryetarë dhe anëtarë të komisioneve për çështjet europiane të parlamenteve të vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe vendeve kandidatë,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve europiane,

Të nderuar kolegë deputetë, Zonja dhe zotërinj,

Ju falënderoj për praninë dhe për angazhimin e parlamenteve që përfaqësoni në mbështetje të politikës së zgjerimit të Bashkimit Europian dhe anëtarësimit të Shqipërisë, çka po dëshmohej edhe

më të lexuarat



'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më



'Asnjë hap pas'/ Dita e 120-të e protestave, pankartat: Edi, po të vjen fundi me ndëshkim!



VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë Hysenit?



Epitafi i frikës, apo frika e epitafit?



Berisha: Vlorë Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan



Berisha: Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan dëshmuar se orteku i opozitës po rritet çdo ditë



gjatë kësaj konference.

Falënderoj në mënyrë të veçantë moderatorin e sesionit, z. Barry Ward , Kryetar i Komisionit për Çështjet Europiane të Parlamentit të Irlandës dhe përfaqësues i Presidencës së BE-së, dhe paraqitësit, znj. Rasa Budbergytë , Zëvendëskryetare e Parlamentit të Lituanisë dhe Kryetare e Komisionit për Çështjet Europiane, për vlerësimet dhe mbështetjen e fortë të anëtarësimi të Shqipërisë!

Megjithatë, kam dëgjuar po aq qartë edhe një mesazh tjetër: rruga drejt anëtarësimi nuk kalon përmes deklaratave politike, por përmes reformave reale, institucioneve funksionale dhe standardeve demokratike të prekshme për qytetarët.

Si zëvendëskryetar i Kuvendit, unë jam përfaqësues i Partisë Demokratike në opozitë.

Për opozitën, anëtarësimi në Bashkimin Europian përbën aspiratën më të lartë kombëtare të Shqipërisë moderne, është projekti që bashkon shumicën dërrmuese të qytetarëve shqiptarë dhe që ka orientuar zhvillimin e vendit tonë që prej vendosjes së pluralizmit politik.

Shqiptarët nuk po trokasin në derën e Europës si një popull në kërkim të identitetit të vet. Identiteti i tyre europian është që në ngjizje të qytetërimit perëndimor si themelues i tij.

Ne si opozitë e kemi mbështetur dhe do të vazhdojmë ta mbështesim pa asnjë rezervë anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Ne kemi mbajtur dhe do të mbajmë çdo kosto që do të na kërkohet drejt këtij qëllimi të lartë, pavarësisht manovrave, shpesh edhe hipokrizisë dhe mashtrimeve të qeverisë.

E bëjmë këtë jo sepse ndajmë të njëjtin vlerësim për mënyrën se si po qeveriset vendi, por sepse interesi europian i Shqipërisë është më i madh se interesi i çdo partie dhe i çdo qeverie të përkohshme.

Me këtë bindje dhe me këtë përgjegjësi, i jemi bashkuar edhe kësaj konference sot.

Por pikërisht sepse e mbështesim me gjithë forcën tonë procesin e integritetit, kemi detyrimin të flasim hapur për problemet që e pengojnë atë.

Reformat e mëdha vazhdojnë si projekte elektorale të Partisë Socialiste e pa konsensusin e nevojshëm politik.

Reforma territoriale po trajtohet pa dialogun e domosdoshëm me opozitën, pushtetin vendor dhe grupet e interesit. Ajo po realizohet në mënyrë të njëanshme.

Qeveria flet për reformë zgjedhore. Por leximi objektiv i raporteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare tregon se standardet demokratike në procesin zgjedhor vazhdojnë të kërkojnë ndryshime emergjente. Ekziston rreziku që edhe kjo reformë të jetë më shumë produkt i vullnetit të mazhorancës për të shkuar drejt farsave të tjera elektorale.

Lufta kundër korrupsionit është një nga testet më të rëndësishme të pjekurisë demokratike të një vendi.

Nuk mund të pretendojmë se po ndërtojmë standarde europiane, ndërkohë që mbrojmë persona të akuzuar apo të përfshirë në afëra korruptive për shkak të interesave politike. Qeveria perdor imunitetin dhe parlamentin për të penguar drejtësinë.

Korrupsioni nuk luftohet duke mbrojtur të korrupuarit; ai luftohet duke mbrojtur ligjin.

Për Partinë Demokratike sot, për Shqipërinë, problemi më i madh me pasoja shkatërrimtare mbi demokracinë, ligjin, shoqërinë dhe ekonominë e Shqipërisë është narkoshteti i kryesuar nga Edi Rama, i pari dhe i vetmi në Evropë.

Në këtë kuadër, sot Shqipëria është eksportuesja kryesore e kanabisit në Evropë.

Kartelet shqiptare të drogës janë transportuesit kryesorë të kokainës dhe ndër aksionerët kryesorë të tregut të saj në Evropë.

Në Shqipëri ato administrojnë portet, të cilat aktualisht janë porta të

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Mos kujtoni se ju kam vjedhur'/ Këlliçi-Ramës: Je kreu i narkoshtetit dhe kryehajduti i shqiptarëve, jep menjëherë dorëheqjen

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

te shqiptarëve administrativë por jo, te cilat mundohen për të bërë të
lira për drogën.

Kartelet shqiptare të drogës në Shqipëri dhe në Amerikën Latine kanë
lidhje direkte me ekzekutivin shqiptar. Pasojat më të rënda të
narkoshtetit janë në ekonominë e vendit.

Në Shqipëri, më shumë se në çdo vend tjetër në botë, janë çvlerësuar
euroja dhe dollari.

Monedhat më të fuqishme në planet janë çvlerësuar përkatësisht me
32% dhe 35%, e po aq janë çvlerësuar edhe eksportet e vendit.

Për rrjedhojë, prodhimi industrial në Shqipëri, sipas Eurostat-it, ka
rënë me 15.3%.

Kurse treguesi i ndërtimit, sektor ku lahen paratë e drogës, është tri
herë më i lartë se mesatarja e BE-së.

Pasojat më të rënda të narkoshtetit pasqyrohen me shokun
demografik të pashembullt në historinë tonë.

Po sipas Eurostat-it, në 10 vitet e fundit emigruan vetëm në zonën
Schengen 1,099,000 qytetarë.

Nëse shtohen edhe ata që kanë emigruar në zona të tjera, del se 47%
e shqiptarëve janë larguar nga vendi.

Regjistri i Gjendjes Civile tregon se lindjet sot kanë rënë në nivelin e
100 viteve më parë, kur Shqipëria kishte nën 1 milion banorë.

Problemi madhor lidhur me narkoshtetin qëndron te mohimi i tij, dhe
në fakt ky mohim është mbështetje e tij, me dashje apo pa dashje.

Po kështu, ideja se narkoshteti në Shqipëri mund të çmontohet nga dy
apo tre prokurorë nuk është aspak realiste. Qëndrime të hapura
politike kundër tij dhe masa të tjera ndaj regjimit janë të
domosdoshme.

Të nderuar miq,

Ne e duam Shqipërinë në Bashkimin Europian jo vetëm për përfitimet
ekonomike apo politike, por sepse Europa përfaqëson demokracinë,
shtetin e së drejtës, institucionet funksionale dhe respektin për
qytetarin.

Pikërisht për këtë arsye, procesi i anëtarësimit duhet të mbetet rigoroz
dhe i bazuar në standarde të matshme. Shqipëria ka nevojë jo vetëm
për anëtarësim formal, por për europianizimin e vërtetë të qeverisjes
së saj.

Ne duam një Shqipëri që drejtohet nga qeveritarë që respektojnë
institucionet, kundërshtarin politik dhe qytetarin e zakonshëm.

Ne duam një Shqipëri që nuk konsumon farsa elektorale dhe burgos
liderin e opozitës në vitin elektorale sic ndodhi me Sali Berishën
themeluesin e pluralizmit politik, ish kryeministrin dhe ish presidentin e
vendi

Ne duam një Shqipëri që organet e sigurisë kombëtare, si SHIK-u apo
Policia, të mos merren peng nga krimi i organizuar e në funksion të tij!
Ne duam që bandat kriminale të jenë aty ku e kanë vendin dhe të mos
mbështeten nga qeveria për të ndryshuar verdiktin popullor në
zgjedhje.

Europa nuk mund të jetë vetëm një fjalë që shqiptohet në Bruksel. Ajo
duhet të ndihet në Tiranë, në Shkodër, në Lezhë, në Korçë, në Vlorë
dhe në çdo komunitet të Shqipërisë.

Ajo duhet të matet me zgjedhje të lira, drejtësi të besueshme,
institucione të pavarura, media të lira dhe respekt për qytetarin.

Në fund të fundit, sfida e Shqipërisë nuk është të bindë Brukselin se
është europiane. Sfida është që çdo qytetar shqiptar ta ndiejë
Europën në jetën e përditshme.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga 'republika e prokurorëve', por
nga republika e të korruptuarve



Kur Rama prek themelet e 'familjes' europiane



Këshilli i Sigurisë Kombëtare, Logu: Aty më shumë ishin mbledhur çunat e Gysit me çunat e Ronit...

TË NGJASHME



Neveriteni diarrenë mediatike të Ramës, e gjithë goditja tek Kayo, Gysi, Roni dhe Vlora!



Bardhi takon Ambasadoren e re të Holandës në Shqipëri: Krimi dhe korrupsioni kanë kapur shtetin



SYRI TV/ Begaj mbledh këshillin e Sigurisë Kombëtare, asnjë diskutim për kompromentimin e SHISH! U! Ramën përballë Spahos



Përplasja e gardistëve të Ramës me gazetaren Ambrozia Meta/ AGSH: S'mund t'i mohohet aksesit për pyetje



Begaj mbledh këshillin e Sigurimit, se Vlora e SHISH fliste me Agasin. Por vetë Rama fliste e bënte gosti me koordinatoren



Kedhi: Rama u izolua në New York, aleatët i kthyen shpinën, regjimi i tij është i braktisur brenda dhe jashtë vendit



Deklaratat skandalozë të kryeministrit, Garo: Edi Rama bëri sot, akt shantazhi politik në zemër të Europës...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIË ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.